

VENDIM
Nr. 77, datë 14.2.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT TË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE NË TURIZËM”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimet “Drejtori i Zhvillimit të Programeve të Turizmit” dhe “Drejtori i Projekteve Zhvillimore të Turizmit” zëvendësohen, përkatësisht, me “Drejtori i përgjithshëm Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse” dhe “Drejtori i përgjithshëm për Zhvillimin e Turizmit”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku